

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-067/2015**

Prishtinë  
2 Nëntor 2016

Në çështjen juridike të:

**L. K.**

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, kryetar , Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK) nr KPCC/D/R/231/2014 i datës 13 mars 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës nr. KPA38058), pas shqyrtimit të mbajtur më 2 Nëntor, mori këtë

**AKTGJYKIM**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e L. K. kundër vendimit të **KKPK-së nr KPCC/D/R/231/2014**, të datës 13 mars 2014.
2. Vërtetohet vendimi i **KKPK-së nr. KPCC/D/R/231/2014** për sa i përket kërkesës nr. **KPA38058**.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 23 tetor 2007, L. K. (më tutje: pala ankuese) si paraqitës i kërkesës ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tutje: AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së tij të pronësisë mbi një banesë që ndodhet në Svetog Igumana, Prizren, kati i parë, me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup> (më tutje: banesa e kërkuar).
2. Pala ankuese i ka dorëzuar këto dokumente në AKP:
  - Një deklaratë të shkruar të M. L. dhe M. M. të datës 7 shkurt 2007 (nr 105).
  - Një kopje të faturës nr. 199 të datës 7 maj 1999, me adresën: S. Igumanova pn.
  - Një kopje të Librezës së Nxënësit në emër të K. K. të datës 25 dhjetor 1999, me adresë: S. Igumanova pn.
3. Më 25 janar 2008, AKP-ja e identifikoi banesën e kërkuar dhe gjeti se banesa ishte e uzurpuar nga një person i panjohur. Ky person refuzoi që të identifikohet dhe nuk e nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes. Po ashtu më 4 mars 2008, AKP-ja e identifikoi banesën e kërkuar duke e publikuar në buletin e AKP-së.
4. Askush nuk mori pjesë në procedurën para KKPK-së.
5. AKP-ja e verifikoi pozitivisht deklaratën me shkrim të datës 7 shkurt 2007.
6. Më 20 dhjetor 2013, AKP-ja kërkoi nga pala ankuese që të dorëzojë prova shtesë për ta mbështetur kërkesën e tij. Pala ankuese nuk e përmbushi këtë kërkesë.
7. KKPK-ja vendosi në vendimin e saj që ta refuzojë kërkesën. Në arsyetimin e saj (paragrafët 10, 50 dhe 51), për aq sa janë relevante, KKPK-ja theksoi se në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese kishte dorëzuar vetëm dy deklarata me shkrim që konfirmonin se ai dhe familja e tij kishin jetuar në banesën e kërkuar. KKPK-ja konstatoi se këto deklarata, pa ndonjë dokumentacion vërtetues, nuk përbënin prova të mjaftueshme për ta dëshmuar të drejtën e tij pronësore të pretenduar. Prandaj, kërkesa e tij ishte refuzuar.

8. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 27 maj 2014.
9. Pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 12 qershor 2014.

### **Pretendimet e palëve**

10. Pala ankuese e kundërshton vendimin e KKPK-së për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike. Ai pretendon se ka qenë pronar i banesës së kërkuar para se ai dhe familja e tij u detyruan të largohet për shkak të konfliktit të armatosur në vitin 1999. Ai më tej pretendon se banesën e kishte fituar nga ndërmarrja “Liria” ku kishte punuar. Udhëheqësija e Ndërmarrjes “Liria” ka pasur t’ia jep vendimin për ndarje banesës por kjo nuk ndodhi kurrë për shkak të konfliktit. Me qëllim që ta dëshmojë punësimin e tij në këtë ndërmarrje , pala ankuese dorëzoi një kopje të librezës së punës. Ai deklaroi se ai nuk është në gjendje të paraqes prova tjera për shkak të konfliktit të lartcekur.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Meritat e ankesës*

11. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se provat e dorëzuara nga pala ankuese kanë të bëjnë vetëm me pretendimin e shfrytëzimit të banesës së kërkuar nga pala ankuese dhe familja e tij në periudhën e viteve 1998 dhe 1999. Megjithatë, asnjëra nga provat e dorëzuara nuk e vërteton pohimin e palës ankuese se Ndërmarrja Tregtare “Liria” ia ka transferuar atij ndonjë të drejtë të shfrytëzimit apo ndonjë të drejtë të pronësisë mbi pronën e kërkuar. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen, pala ankuese nuk ka arritur t’i dëshmojë të drejtat e tij pronësore mbi pronën e kërkuar.
12. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se vendimi i KKPK-së është marr me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike e mbi bazën e së cilës drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Vendimi ankimor nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të LPK-ës të natyrës absolute për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare apo të atyre shkeljeve që janë me

ndikim në drejtshmërinë, rregullsinë dhe ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.

*Konkludim*

13. Nga arsyet e paraqitura , sipas dispozitës së nenit 13.3.c të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (më tutje: Ligji nr. 03/L-079), Gjykata Supreme vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

14. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredinji, Kryetar i Kolegjit**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**